

Çka do të thotë sot në botën e globalizuar socialdemokracia?
Ç'është demokracia sociale?

A është i mjaftueshëm interesimi i qytetarëve për politikë?
A mund të ngjallet serish interesimi i tillë?

A janë kompatible dinamika ekonomike dhe drejtësia sociale?
Cilat politika konkrete janë treguar të aplikueshme?

Sa kanë qenë ato të suksesshme?

Këto dhe pyetjet e tjera janë të rëndësishme në të gjitha rajonet e botës. Përmes editimit të publikimit "**Forumi demokracia sociale – vizionet dhe opsionet për Evropën Juglindore**" Fondacioni Fridrih Ebert (Friedrich-Ebert-Stiftung) dëshiron të jap kontributin e vet në debatin që zhvillohet në Evropën Juglindore në këtë temë. Publikimet do të përcillen nga forumi në internet (www.forum-social-democracy.org). I ftojme të gjithë lexuesit të marrin pjesë aktive në këto debate.

Fondacioni Fridrih Ebert
Zyra në Beograd
Simina 1
11000 Beograd
Serbi dhe Mali i Zi

Fondacioni Fridrih Ebert
Zyra në Sarajevë
Sumbula Avde 7
71000 Sarajevë
Bosnjë dhe Hercegovinë

Fondacioni Fridrih Ebert
Zyra në Zagreb
Prashka 8
10000 Zagreb
Kroaci

- *Teksti del edhe në gjuhën maqedone, shqipe, bullgare dhe rumune.*
- *Të gjitha tekstet mund të gjenden në internet, në www.fes.org.yu*

'Krizë dhe zgjidhja në social-demokracinë evropiane': Ekonomia e re politike e modelit social evropian

Katër hapa strategjik

Zgjidhja e shtetit social e shfaqur pas vitit 1945 nuk është më adekuate për botën e sotme. Përmasat e sfidave të ardhshme janë evidente: intensifikimi i konkurrencës ndërkombëtare, popullata e shtyrë në moshë, ndërrimi i roleve të gjinive në amvisëri dhe tregjet e punës, teknologjitë e reja, tensionet shoqërore në rritje dhe pabarazitë gjithnjë e më të thella. Po qe se qendra e majtë vazhdon që vetëm t'i mbrojë të drejtat ekzistuese në shtetin social dhe zgjidhjet mbi ndarjen, ajo do të jetë e aftë për të reaguar në mënyrë adekuate.

Në vend të kësaj, social-demokratët duhet të fillojnë me formësimin e strategjisë politike e cila ndryshon nga agjenda politike. [1] Kjo përfshin katër hapa strategjik:

1. Shteti i fuqishëm social është parakusht i ekonomisë ndërmarrëse

Social-demokratët kanë nevojë për **interpretim progresiv që ndërlidh politikën ekonomike dhe sociale**. Në epiqendër të argumentimit social-demokrat është ideja që shteti i fuqishëm social është parakusht i ekonomisë ndërmarrëse dhe se e plotëson atë. Kjo kërkon politikë aktive të tregut të punës, kujdes ndaj fëmijëve dhe baraspeshë ndërmjet punës dhe jetës si rrugë në drejtim të përparimit ekonomik. Siç thotë Göran Persson, kryeministër suedez, „Shteti social i kontribuon lirisë dhe ndërmarrësisë së njerëzve. Njerëzit të cilët ndihen të sigurt kanë guximin të provojnë diçka të re“.

2. Sistemi inkluziv pensional, kujdesi universal ndaj fëmijëve dhe dispozita e fuqishme për pushimin prindëror

Social-demokratët duhet të fokusohen në ndërtimin e institucioneve progresive për të ardhmen, siç kanë vepruar gjatë një gjysmë shekulli të fundit: sistemi inkluziv pensional, kujdesi universal ndaj fëmijëve dhe dispozita e fuqishme për pushimin prindëror. Në Mbretërinë e Bashkuar (UK), Qeveria Laburiste ndërton infrastrukturën nacionale të qendrës për kujdesin ndaj fëmijëve. Ata u ofrojnë ndihmë jo vetëm prindërve me fëmijë, por në atë mënyrë kultivojnë edhe kapitalin shoqëror. Ata i ndërlidhin vlerat social-demokrate në indin e shoqërisë, dhe ka pak gjasa që në të ardhmen qeveritë do t'i demantojnë dhe mënjanojnë.

3. Evropeizimi i kërkimit të drejtësisë sociale

Në botën e cila globalizohet, social-demokratët duhet t'i formësojnë instrumentet e politikës dhe të koordinojnë aktivitetin përtej kufijve tradicionalë të shtetit të kombit. Synimi drejt „Keynezianizmit në një vend“ social-demokratik është treguar iluzor. UE dhe institucionet ndërkombëtare, më shumë në aspektin gjenerues, janë duke u bërë të rëndësishme kyçe për realizimin e ambicieve tona për të drejtën sociale në shekullin 21.



4. Të përmbushën nevojat e shumicës

Përfundimisht, social-demokratët duhet t'i mbështesin shtetet sociale të cilat i përmbushin nevojat e shumicës, e jo vetëm të pakicës e cila është e varfër. Në fushat siç janë kujdesi për fëmijët dhe pensionet, duhet që shumicës t'i jepet rol më i madh në institucionet progresive.

Para së gjithash, social-demokratëve u duhet një vizion afatgjatë i shoqërisë së mirë e cila mbështetet në karakterin e sigurisë dhe të solidaritetit të mbështetur në argumente, analizë, politikë dhe strategji. Ata duhet edhe më tej të ngadhënjejnë ndaj së djathtës me argumentet e tyre të fuqishme progresive.

Reforma është *mike* e drejtësisë më të madhe sociale në Evropë, e jo armike e saj

Me rastin e trajtimit të modelit social, pikë nisjeje jona duhet të jetë pranimi që debati për reformë në Evropë është fokusuar gabimisht në çështjen e qëndrueshmërisë së shtetit social: a do të mund të mbijetojë modeli social evropian dhe a e meriton ai një gjë të tillë? Natyrisht, ekzistojnë sfida mjaft reale deh konkurruese me të cilat ballafaqohet Unioni evropian.

Mirëpo kjo është një pikënisje e gabueshme; qendra e djathtë ka krijuar një zgjidhje të rrejshme, duke e arsyetuar reduktimin e shtetit social me nevojën që të mundësohen globalizimi, tregtia botërore dhe përshtatja ndaj ndryshimeve ekonomike.

Nuk ka dëshmi kurrfarë dëshmish bindëse që tregojnë për atë që shteti social bëhet jo konkurrues apo i papranueshëm për shkak të këtyre presioneve të jashtme. Në të vërtetë, debati për reformën ESM duhet të konsistojë në atë se në ç'mënyrë reforma e modeleve të tilla i rindanë mundësitë, u ndihmon të rrezikuarve, i mbron të marginalizuarit dhe e forcon drejtësinë sociale në Evropë. Reforma është, në të vërtetë, *mike* e drejtësisë më të madhe sociale në Evropë, e jo armike e saj.

Por, social-demokratët duhet në mënyrë më bindëse t'i fusin brenda suazave argumentet e tyre në të mirë të reformës, duke i shprehur përparësitë e tilla kyçe të drejtësisë sociale. Dihet botërisht se është ky një koncept i paqartë, mirëpo politologu gjerman Wolfgang Merkel ka përpiluar listën e pesë prioritetëve të drejtësisë sociale në shoqërinë post industriale:

1. Lufta kundër varfërisë – jo vetëm e pabarazisë ekonomike, por në bazë të faktit që varfëria (varfëria me këmbëngulësi) kufizon aftësinë e individit për të qenë i pavarur dhe i me besim në vetvete.

2. Aplikimi i standardeve më të larta të mundshme për arsimim dhe stërvitje, të kultivuara në qasjen e barabartë dhe të drejtë për të gjithë.
3. Sigurimi i punësimit për të gjithë që dëshirojnë dhe janë të aftë për të punuar.
4. Shteti social i cili ofron mbrojtje dhe dinjitet.
5. Kufizimi i pabarazive në të ardhura dhe në pasuri po qe se ato e pengojnë realizimin e katër qëllimeve të para apo e rrezikojnë kohezionin e shoqërisë.

Ajo që mbrojtësit e situatës së *status quo*-së duhet të kuptojnë është që modelet evropiane të kapitalizmit social nuk përputhen në tërësi me këto parime themelore të drejtësisë sociale. Mementalisht: [2]

- Në shumicën e vendeve – anëtare të UE-së nuk ekziston më një punësim i plotë. Madje edhe vendet (shtetet) me shkallë të lartë të punësimit, siç janë Suedia dhe MB (UK) kanë probleme me popullatën joaktive të moshës për punë dhe me kërkesat gjithnjë e më të mëdha për beneficione në bazë të sëmundjes dhe invaliditetit.
- Sigurimi kundër rreziqeve sociale është shumë anues: sistemet e mbrojtjes sociale japin sigurime kundër rreziqeve „të vjetra“, siç janë papunësia afatshkurte, sëmundja dhe varfëria në pleqëri, por jo edhe aq kundër rreziqeve „të reja“ – prindërit vetshqyes, shpërbërja e lidhjes dhe paaftësia në pleqëri.
- Është shregulluar raporti i drejtësisë në mes të gjeneratave, sepse pensionistët kalojnë më mirë, ndërsa është në rritje varfëria në familjet me fëmijë dhe varfëria ndër fëmijët e tërë Unionit evropian.

- Sistemi i raporteve industriale e mbron fuqinë e privilegjuar interne punuese të sindikatave të fuqishme dhe marrëveshjeve kolektive, por i përjashton punëtorët e moshuar dhe të plogësht në ekonominë konkurruese shërbyese.
- Pabarazitë në të ardhura dhe pasuri janë në rritje në UE sipas raportit të Esping-Anderson-it, ndërsa rrezikimi i trashëguar social bëhet gjithnjë e më i rrënjosur në mesin e fëmijëve. Shkalla e varfërisë në mesin e fëmijëve të UE-së është edhe më tutje në rritje.

Mirëmbajtja e shteteve ekzistuese sociale nuk mjafton më për forcimin e drejtësisë sociale

Edhe një mori faktorësh të cilët shkaktojnë krizë në shtetin social kanë të bëjnë me dukurinë e sfidave të mëdha aktuale dhe strukturale në 20 vitet e kaluara.

Kujdesi social në të ardhmen duhet të ballafaqohet me ndryshime të mëdha egzogjene - shoqëria që mblakët gjithnjë e më shumë kërkon që të merren sërish në shqyrtim konceptcionet tradicionale të pensionimit; shfaqja e mënyrës së jetesës pas skamjes; ndryshimet sociale siç është dobësimi i familjes tradicionale; si dhe efekti i dobët i ekonomisë evropiane pas fillimit të viteve të '90-ta.

- Ta marrim popullatën e cila është gjithnjë e më e moshuar. Në UE-në e sotme – 25, mbi 70 milionë njerëz janë mbi moshën 60 vjeçare, që paraqet 20% të banorëve. Mbi 30% e njerëzve janë mbi moshën 50 vjeçare. Mesatarisht, njerëzit jetojnë më gjatë, mirëpo shkak kryesor është nataliteti i ulët. Po qe se e krahasojmë UE-në me SHBA-të, ndonëse UE ka 455 milionë banorë, në raport me 295 milionë në SHBA, SHBA-të praktikisht do ta zënë UE-në në mesin e këtij shekulli, po qe se vazhdon trendi ekzistues.
- Masa e njerëzve të trashë në UE është sot 18%, në krahasim me 25% në Amerikë. Trashja shpie drejt diabetit, në ç'mënyrë rritet presioni mbi sistemet shëndetësore. Në përgjithësi, sëmundjet kronike, pirja e duhanit, sëmundjet e zembrës, diabeti dhe kanceri – që paraqesin 75% të të gjitha sëmundjeve, janë shkaktuar më shumë nga mënyra e jetës, se sa nga infeksionet.
- Në shumicën e vendeve të UE-së, përqindjet e divorceve janë gjithnjë e më të mëdha, ndërsa përqindjet e kurorëzimeve (martesave) më

të ulëta se në të kaluarën. Familjet janë më mobile dhe me më pak lidhje të gjera familjare që dikur paraqitnin burimin e përkrahjes shoqërore. Po ashtu, jemi dëshmitarë të shtimit të përpjesëtimit të „familjeve jokonvencionale”: gratë që i lindin vetë fëmijët dhe çiftet e gjinisë së njëjtë në vitin 1980, në MB, 12% të të gjithë fëmijëve i kanë lindur jashtë martesë; më 2004 ky numër është shtuar në 42%.

- Ekzistojnë kategori të reja të varfërisë dhe të skamjes në të gjitha vendet industriale: emigrantët, të ligjshëm apo jo, që i nënshtrohen eksploatimit; familjet e shkatërruara dhe vështirë të zëvendësueshme; të sëmurët mentalë; edhe viktimat e dhunës, veçmas femrat që i ekspozohen dhunës familjare, siç ka zbuluar kohë më parë Geoff Mulgan në raportin për “Young Foundation” (www.yongfoundaation.org.uk). Në vështrim të femrave në MB, të moshës ndërmjet 19 dhe 44 vjeçare, dhuna familjare paraqet sot shkaku kryesor të vdekjes – para kancerit dhe fatkeqësive të komunikacionit. Po ashtu ka shumë të rrijë me një numër të madh të kërkesave të pa përmbushura.
- Sipas komentatorëve pesimistë, në 20 vitet e fundit shënohet një rënie e theksuar në potencialin e rritjes në UE, nga 2,4% në fillim të viteve 1990, në më pak se 1% në periudhën 2000.-03, që paraqet lloj të ri të presionit në të dalat publike.

Pra, në të gjitha shoqëritë shfaqën presione të fuqishme që janë në rritje brenda këtyre shoqërive dhe mbi ato shoqëri. Në të vërtetë, përpjekja për t'u ruajtur status-quo-ja në shtetet sociale dhe modelet sociale të Evropës tashmë nuk mjafton për forcimin e drejtësisë sociale.

Drejt kompromisit të ri ndërmjet individualizmit dhe solidaritetit

Nuk ka arsye që social-demokratët të humbin besimin në idenë e shtetit aktiv si instrument efikas i drejtësisë sociale dhe i modernizimit ekonomik. Ideat afatgjate të shtetit social – solidariteti, barazia, liria – janë edhe sot njësoj të vlefshme sikurse edhe para njëqind vitesh – por institucionet dhe programet duhet të përtërihen për shekullin 21.

Kjo kërkon nga social-demokratët që të përqendrohen me më intensitet në sfidat e ardhmërisë; që do të thotë, edhe në sfidat që vijnë pas disa deceniesh. Trendët e përmendura – shoqëria e moshuar, shpërbërja e familjes tradicionale, dobësimi relativ i ekonomisë evropiane – do të mbesin shumë të theksuara. Por qendra e majtë duhet të jetë e vendosur për të vepruar në pajtim me botën e cila ndryshon, sepse pejsazhi politik zhvillohet shpejt dhe formohen sfida të reja, që do të kenë ndikim të pamatshëm në modelin social evropian.

- Ndikimi i llojllojshmërisë më të madhe etnike dhe kulturore në shtetet sociale evropiane;
- Rritja e individualizmit kulturor dhe ekonomik me kërkesa gjithnjë më të mëdha për mëvetësi dhe vetë realizim;
- Sfida konkurruese e vendeve të reja anëtare në Evropën Lindore, Indisë dhe Kinës – gjë që

shkakton frikësimet lidhur me mënyrën evropiane të jetesës.

Sfidat janë të ndërlikuara, të gërshetuara dhe jo të kuptuara më së miri në një pjesë të madhe të Evropës – madje as në mesin e ekspertëve. Po ashtu ekzistojnë edhe koftra-trendët, si dhe nuanca vitale.

Në qendër të vëmendjes së këtyre sfidave të ardhshme është tema e bashkësisë së re – që përbush synimin e individëve për mëvetësi dhe liri të zgjedhjes, me dobi dhe përgjegjësi të bashkësisë: shkurt, një kompromis i ri në mes të individualizmit dhe solidaritetit në kohën moderne.

Para së gjithash, duhet ta kemi parasysh që bota më pak e dëgjueshme, por gjithnjë e demokratike kërcënohet me futjen e krizës së legjitimitetit në politikë që përpiket ta ruaj raportin tradicional në mes të qytetarëve dhe shtetit. Social-demokratet shumë shpesh bien në kurthin e besimit që një raport i tillë mund të ngrihet në kohë. Duke qe nëse institucionet që janë formësuar për kohën e kaluar dukën gjithnjë e më pak të afta për të reaguar në presionet dhe sfidat e botës së sotme, e djalhta i forcon gjithnjë e më shumë sulmet e saj. Megjithatë, imperativ yni nuk duhet të jetë që ta refuzojmë rolin e shtetit, por që ta reformojmë.

Llojllojshmëria përballë solidaritetit: sfida që nuk duhet injoruar

Trendi i parë me të cilin do të merrem më hollësisht – dhe i cili në vitet e ardhshme do të jetë pa mëdyshje gjithnjë e më i theksuar – është raporti ndërmjet shtetit social, përkatësisë etnike dhe llojllojshmërisë. Natyrisht, është ky një terren jashtëzakonisht kompleks dhe i ngadalshëm.

Mirëpo statistikat zbulojnë shumëçka. Numri i shtetasve të huaj në Evropën Perëndimore është shtuar nga katër milionë në vitin 1950, në 21 milionë në vitin 2000. Sot, në vendet e zhvilluara një i dhjeti banor është emigrant. Numri i shtetasve të vendeve që nuk janë anëtare të UE-së, në Ev-

ropë është shtuar nga 8,4 në 13 milionë që nga viti 1985. Natyrisht, ne, si e majtë, do të duhej të jemi të përcaktuar për integrim:

- Duke pranuar llojllojshmërisë si në mesin e emigrantëve ashtu edhe në mesin e banorëve vendas.
- Duke penguar diskriminimin, racizmin dhe eksploatimin.
- Duke siguruar barazi të barabartë ndaj shërbi- meve qeveritare.
- Duke nxitur pjesëmarrjen në të gjitha fushat shoqërore.
- Duke lehtësuar pjesëmarrjen politike dhe shndërrimin e emigrantëve në qytetarë të plotë të këtyre shteteve.

Ndërkaq, duhet ta kemi parasysh skepticizmin gjithnjë e më të madh në matricën e popullatës në shoqëritë industriale perëndimore në vështirim të multikulturizmit liberal që ka nisë në vitet e '60 dhe të '70-ta. Në shumë vende përkrahja ndaj kësaj është në rënie.

Duhet të pranohet që në ndërkohë janë shfaqur një mori dilemash morale dhe politike për social-demokratët, të nxitur nga zhvillimi i dy eksperimenteve historike-shoqërore në 50 vitet e kaluara. I pari konsiston në shtetin social dhe në pikëpamjen për shfrytëzimin e përbashkët të resurseve me të huajt si qytetarë të barabartë. I dyti ka të bëjë me rritjen dhe krenmtimin e llojllojshmërive dhe ndryshimeve

shoqërore, etnike dhe racore – dhe të kufijve të hapur që i kontribuojnë llojllojshmërisë më të madhe në shoqëritë moderne liberale [3].

Kjo ka bërë që të shfaqën disa dilema progresive për qendrën e majtë pas vitit 1970. Dilema më e theksuar ka të bëjë me gjoja tensionin ndërmjet solidaritetit dhe llojllojshmërisë. Në esencë, siç pohohet, sa më e dobët të jetë ndjenja e përkatësisë së ndërsjellë, aq më pak jemi të prirë që ta përkrahim shtetit zemërgjerë social.

Në të vërtetë, përmasat e shtetit social në Evropë kanë mbetur në nivelet historikisht të larta, madje edhe krahas rritjes së llojllojshmërisë së të gjitha llojeve. Mirëpo, puna shkencore e sociologëve Robert Putnam dhe Albert Alesin tregon për ekzistimin e kompromisit negativ në mes të dallimit racor dhe etnik, si dhe të mbajtjes kolektive mbi bazën e reciprocitetit dhe të solidaritetit.

Efekt i kombinuar i mirëqenies në rritje, i shoqërisë së moshuar dhe i erozionit të klasës historike dhe të solidaritetit nacional do të sjellë reduktimin e mbrojtjes sociale, veçmas të rindarjes përmes dhënieve sociale.

Në të kaluarën, social-demokratët kanë qenë të gatshëm që të ballafaqohen me çështjet e sigurisë dhe të identitetit. Ata, jo pa arsye, supozojnë që forcimi i profilit të preokupimeve të këtilla i shkojnë për shtati të djathtës politike – por e majta duhet t'i neutralizojë frikësimet e tilla, madje edhe t'i kthejë në përparësi po qe se dëshirohet të arrihet një lulëzim i modelit social në të ardhmen.

Rritja e individualizmit kulturor dhe ekonomik

Trendi tjetër ka të bëjë me rritjen e individualizmit kulturor dhe ekonomik dhe ndikimin e tij në mbajtjen kolektive dhe financimin shtetëror të shërbimeve publike.

Pohimi që trendët sociale i bëjnë individët më pak të prirë ndaj zgjidhjeve kolektive sot është mjaft i përhapur. Teoria ekonomike dikton që me shtimin e të hyrave në dispozicion, njerëzit duan të investojnë pjesë gjithnjë e më të madhe të të hyrave të tyre në shërbime, siç janë mbrojtja shëndetësore dhe arsimit, dhe këtë me më endje e bëjnë privatisht, se sa përmes shtetit – duke e nxitur rrezikun nga shfaqja e reaksionit të obliguesve tatimor të klasës së mesme që ka mbizotëruar në SHBA

Është evidente që në 50 vitet e fundit individët i ndjekin gjithnjë e më shumë synimet e tyre, duke realizuar kontroll gjithnjë e më të madh ndaj jetës së vet se që ka qenë rasti në ekonominë masovike industriale në vitet e '50-ta. Mirëpo, nuk është individualizmi i vërtetë "pa pagesë për të gjithë". Përkundrazi, kjo tregon për dëshirën që rruga jetësore personale të ndërtohet në mënyrë më aktive, evidente në kërkesat e reja për mëvetësi dhe çlirim të identitetit vetjak në deceniet e fundit.

Gjithnjë e më shpesh, njerëzit ndihën më pak të fuqishëm si qytetarë se sa si konsumues në tregjet globale. Çka flet kjo statistikë e thjeshtë: sot në Britani, numri i transaksioneve sipas kartelave



debisë është dhjetë herë më i lartë se që ka qenë në vitin 1991, ndërsa përdorimi i kartelave të kre-disë është në rënie. Njerëzit sot përherë shpenzo-

jnë dhe presin që shërbimet në sektorin publik të jenë në nivel të njëjtë të kualitetit sikurse në atë privat.

Arsimimi për ballafaqim me sfidat e konkurrencës ndërkombëtare

Transformimi ekonomik i vendeve të Evropës Lindore në fazën e aderimit, dhe natyrisht Indisë dhe Kinës, do të ketë pasoja të thella në Evropë në 20 vitet e ardhshme.

Tashmë ekzistojnë parashikime të zymta rreth ardhmërisë së botës industriale. Në të vërtetë, edhe në Evropë, edhe në Amerikë janë të pranishme grupet e mundshme të cilat insistojnë në theksimin më të lartë ndaj politikave proteksioniste, nën frikën e ndikimeve kërcënuese të ndikimit në rritje dhe punësim.

Mirëpo, kthesa e tillë drejt proteksionizmit do ta izolonte Evropën nga tregjet globale, që kryesisht kalojnë nëpër revolucionin e shkaktuar nga fuqia prodhuese në rritje e Azisë. Kjo kishte për të pasur pasoja afatgjate katastrofike për aftësinë e Evropës për të bërë gara në ekonominë globale, që, në fund do të shpinte drejt erozionit të standardit jetësor në UE.

Deficiti i Evropës në ekonominë e diturisë është po ashtu në rritje, ndërsa efekti në MB është diç

më i mirë se mesatarja evropiane: nuk janë SHBA-të kërcënimi i vetëm konkurrues – Kina dhe India janë duke i arritur shumë shpejt.

Për t'u mbajtur aktive shtetet sociale të së ardhmes, Evropa duhet të identifikojë dhe ndërtojë burime të reja të përparësisë krahasuese. Do të ishte mendjehetësi po të vështroheshin kohezioni social dhe konkurrenca ekonomike si kundërshtime; edhe njëra edhe tjetra shkojnë bashkërisht.

Prandaj, investimi në arsimim dhe stërvitje mbetet nevoja themelore e Evropës. Momentalisht investimi në hulumtime brenda UE-së është shpesh i ndarë në mes të një numri tejet të madh të institucioneve. Në SHBA, trupat hulumtuese janë shumë më të disiplinuar dhe i përqendrojnë mjetet në një numër të kufizuar të qendrave të përsosjes. Amerika e përhap më shumë arsimimin me një dinamikë të shpejtë. Evropa duhet të ndryshojë po qe se dëshiron ta mbajë hapin me dinamikën gjithnjë e më të shpejtë të prodhimit të njohurive.

Përfundim: nga shteti i cili mbron drejt shtetit i cili aftëson

Shkurtimisht do t'i bëja një vështrim zgjidhjeve politike. Social-demokracia gjatë historisë ka bërë përpjekje që ta kombinojë efikasitetin ekonomik dhe drejtësinë sociale. Në kontekst të sfidave të ardhshme, shteti social i së ardhmes do të duhet të sigurojë më sa vijon:

1. Të drejtat të cilat janë të kushtëzuara: Si përgjigje në llojlojshmëri, kontratë më eksplicite ndërmjet qytetarëve të vendosur dhe shoqërisë. Kushtëzimi dhe transparenca e të drejtave duhet të forcohen po qe se dëshirohet që njerëzit të vazhdojnë t'ia japin së paku

një të tretën e të ardhurave të tyre shtetit. Për shembull, beneficionet duhet të kush-tëzohen me sjelljen përkatëse, si është, bie fjala, përcaktimi që me gjithë seriozitetin të kërkohet punë gjatë kohës sa merret ndihmë për papunësi.

2. Ofrimin e zgjedhjes më të madhe: E majta duhet të kanalizojë individualizëm më të fortë kulturor dhe ekonomik duke ruajtur në mënyrë solidare mbajtjen kolektive e cila ofron zgjedhje më të madhe, duke e shtuar kontrollin personal të individit në fushat siç janë ambulancat apo shkollat fakultative. Njerëzve duhet t'u mundësohet që në mënyrë më të drejtpërdrejtë ta formësojnë shtetin social me ndihmën e shërbimit publik, në pajtim me nevojat e tyre vetjake.
3. Shpërndarjen e pasurisë mbi bazë më të gjerë: Të mirat dhe pasuria - produkt i prosperitetit tonë në ekonominë globale – do të duhej të ndaheshin sa më gjerë. Në MB, Qeveria bën eksperimente me "fletë obligacionet e fëmijëve" ("Baby Bonds") – me llogaritë e kursimit për çdo fëmijë për të cilin shteti paguan kontribut të rëndësishëm. Sfi-da jonë është që të ndërtojmë shtetin social i cili është në pajtim me botën e pasigurisë dhe të ndryshimeve gjithnjë e më të mëdha, por po ashtu edhe në harmoni me synimet dhe kërkesat gjithnjë e më të mëdha për mëvetësi.

4. Nxitjen e mobilizimit social: Shtetet sociale duhet t'i nxitin synimet dhe mobilizimin social, duke u përqendruar në atë që t'u bëjnë të mundur punonjësve më të varfër që të nxirren nga puna me një pasiguri permanente, si dhe me pagesë të dobët. Kjo do të thotë se duhet të mbrohen njerëzit, jo vetëm vendet e punës, duke aplikuar politika të tilla të cilat i aftësojnë individët për ndryshime në tregun e punës.

5. Të aktivizojë dijen: Për Evropën, sfida qëndron në "aktivizimin e dijes". Nevojiten nxitjet për orientimin e investimeve më të mëdha private në universitete. Secili punonjës do të duhej të ketë të drejtë në shtesën vjetore për mësim gjatë tërë jetës, në mënyrë që të mund të paguaj stërvitjen apo shkollimin.

Modeli social evropian i së ardhmes kërkon aftësimin, përkatësisht fuqizimin e shtetit të shekullit 21. Për t'u siguruar drejtësia sociale në të ardhmen do të jetë e domosdoshme të bëhet reforma e modeleve sociale dhe e shteteve sociale në Evropë. Thënë haptas, e majta në Evropë gjatë dekadës së fundit mjaft shpesh ka qenë konzervative, ndërsa social-demokratët janë pikërisht ata që sot duhet të jenë në anën e modernizimit dhe të ndryshimeve, në përputhje me realitetet e reja të jetës së njerëzve. Për të mbijetuar social-demokracia, duhet të bëjmë më shumë në mënyrë që të arrihen ndryshimet në njëzet vitet e fundit – duhet të trasojmë rrugë të re drejt ardhmërisë, e cila është edhe progresive, edhe e drejtë.

